



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 2.3.2021, ora 09.00

Drejton mbledhjen:

Mirela Kumbaro – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 23 dhe 26 shkurt 2021
2. Seancë dëgjimore me kandidatët për katër vendet vakante për anëtarë të KDRTSH

(Vendimet e Komisionit nr. 2, 3, 4 dhe 5/2021)

Marrin pjesë:

Ramazan Gjuzi, Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Amra Barova, Erion Piciri.

Mungojnë:

Enada Kapllani dhe Fatjona Dhimitri.

Të ftuar:

Kandidatët për vendet vakante për anëtarë në KDRTSH:

1. Milena Selimi
2. Albert Minga
3. Artan Puto
4. Suela Zalla
5. Thanas Goga
6. Luljeta Leshanaku
7. Mikaela Minga

HAPET MBLEDHJA

Mirela Kumbaro – Mirëmëngjesi edhe një herë të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e datës 2 mars. Siç jeni njoftuar nga sekretaria, sot në rendin e ditës kemi: miratimin e procesverbaleve të datave 23 dhe 26 shkurt, sepse në mbledhjen e kaluar nuk e miratuam procesverbalin e datës 23, prandaj do ta votojmë sot.

Në pikën e dytë, kemi seancë dëgjimore me kandidatët për plotësimin e katër vendeve vakante për anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së. Në fakt, janë katër vendet e fundit të mbetura vakant nga procesi që kemi nisur të gjithë së bashku.

Përpara se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, më lejoni të verifikoj kuorumin.

Zoti Ramazan Gjuzi, kryetari, vazhdon të jetë i sëmurë me COVID dhe i urojmë shërim të shpejtë, të plotë dhe sa më të lehtë.

Mirela Kumbaro, prezent; Fidel Ylli, prezent; Musa Ulqini, prezent; Vilma Bello, prezent; Ismet Beqiraj, prezent; Fadil Nasufi, prezent; Adelina Rista; Bujar Çela, prezent; Almira Xhembulla, prezent; Lindita Nikolla, ende nuk e shikoj në linjë; Enada Kapllani, nuk është; Fatjona Dhimitri, nuk është; Klajdi Qama, prezent; Kostaq Papa, prezent; Selami Jenishehri, prezent; Amra Barova, prezent; Erion Piciri, prezent.

Faleminderit!

Dakord, meqenëse plotësohet kuorumi i nevojshëm, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të datës 23 shkurt, i cili është dërguar me *e-mail*. Kush është dakord?

Miratohet. Faleminderit!

Miratimi procesverbalit të datës 26 shkurt, i cili është dërguar, gjithashtu, me *e-mail*. Kush është dakord?

Miratohet.

Faleminderit!

Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës: seancë dëgjimore me kandidatët që kanë aplikuar për anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së. Siç jeni njoftuar nga sekretaria, bazuar në memon e

Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura, aktualisht rezultojnë katër vende vakante për anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së, të krijuara nga mbarimi i mandateve të zotit Elidon Haliti, zotit Saimir Kumbaro, zotit Pashk Përvathi dhe zotit Artan Peqini.

Në përputhje me nenin 94, pika 3, të ligjit 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton që për plotësimin e çdo vendi vakant për anëtar të Këshillit Drejtues nevojiten jo më pak se 4 kandidatura, ju bëj me dije se në komision janë paraqitur 16 kandidatura, 9 prej të cilëve janë rikandidime dhe janë dëgjuar nga komisioni gjatë muajve shkurt, pra përpara 10 ditësh. Meqenëse disa nga këta kandidatë janë dëgjuar dhe u janë nënshtruar pyetjeve të kolegëve vetëm pak ditë më parë, unë propozoj që të vijojmë me dëgjesën e 7 kandidatëve të tjerë të rinj, të cilët paraqiten për herë të parën në komision dhe do të paraqesin platformat e tyre, si dhe do t’u përgjigjen pyetjeve të anëtarëve të komisionit. Kush është dakord që të procedojmë kështu?

Miratohet.

Faleminderit!

Emrat e kandidatëve që kanë aplikuar dhe do të paraqiten në këtë seancë dëgjimore janë:

Milena Selimi, Albert Minga, Artan Puto, Suela Zalla, Thanas Goga, Luljeta Leshanaku, Mikaela Minga

Paraprakisht të gjithë kandidatët kanë marrë njoftim nga sekretaria e komisionit për oraret që duhet të paraqiten, për kohën që kanë në dispozicion. Kandidatët do të kenë nga 10 minuta për çdo prezantim.

Atëherë, fillojmë me kandidaten e parë në listë të programuar për sot.

Ftoj zonjën Milena Selimi për të prezantuar interesin e saj lidhur me postin vakant të anëtarit të Këshillit Drejtues në RTSH.

Zonja Selimi, fjala për ju.

Milena Selimi – Përshëndetje!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Unë kam kandiduar për vendin vakant të anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së për një arsye shumë të thjeshtë, sepse karriera ime në gazetari ka nisur nga ky institucion shumë i rëndësishëm.

Kam një karrierë në gazetari, në medien e shkruar dhe atë elektronike, e cila përkon në një hark kohor deri në 30 vjet. Duket si kohë e gjatë, por, në fakt, kam lëvizur, kam ndryshuar dhe jam përpjekur që gjatë gjithë kohës së karrierës sime dhe eksperiencës sime medietike të marr pjesë në

transformimet e medias, të cilat janë shumë të rëndësishme. E them këtë, sepse fillimet e mija në Radio Tirana janë në vitin 1992, i cili është një vit shumë i rëndësishëm, ku Radio Tirana dhe në përgjithësi i gjithë institucioni i RTSH-së pësoi atë transformimin e duhur dhe të nevojshëm. Jam krenare që kam qenë pjesë e këtij ndryshimi, por duhet ta dini që nuk ka qenë aspak e thjeshtë, sepse është një transformim që vjen pas një mbyllje dhe pas një izolimi, pasi fjala e lirë ishte e palejueshme. Pra, duhet ta kuptoni që ky transformim që po i ndodhte RTSH-së në këtë periudhë, ky lloj transformimi që po i ndodhte RTSH-së në këtë periudhë, flas për vitin 1992 deri në vitet '98-'99, që mendoj se janë vitet më të mira të RTSH-së, sepse ka pësuar transformime të jashtëzakonshme.

E nisa duke folur për karrierën time të parë, pasi është, pak a shumë, si dashuritë e para, të cilat janë shumë të dashura. Ky është institucioni, i cili më ka rritur, më ka formësuar nga ana profesionale dhe aty kam mësuar të kuptoj bashkimin dhe ndërthurjen që bëhej ndërmjet traditës gazetareske të atyre gazetarëve të nderuar të këtij institucioni të para viteve '90, por që nuk patën mundësi ta çonin deri në fund fjalën dhe krijimtarinë e tyre. Kështu, le të themi, unë i përkas një brezi, të cilin më pëlqen ta quaj revolucionar, sepse transformoi këtë institucion së bashku edhe me shumë kolegë të tjerë të nderuar, të cilët fatkeqësisht ose për fatin e tyre të mirë u bënë pjesë e medieve private, që do të thotë se ky institucion nuk e pati mundësinë që të mbante kuadrot e parë, kuadrot të cilët ai i formësoi.

Eksperiencia ime në Radio Tirana ka nisur shumë thjesht, ka nisur si një përkthyes në sektorin e radios së jashtme, sepse, përveçse gazetarë, unë kam edhe një eksperiencë si përkthyes, e cila është më shumë se 20-vjeçare. Unë përkthej një nga gjuhët ballkanike, ndaj dhe eksperiencia ime e parë dhe mikrofoni im i parë në Radio Tirana ka qenë pikërisht në sektorin e radios së jashtme, në sektorin e gjuhës bullgare. Siç e thashë, në vitin '92 nisa krijimtarinë time në sektorin e fëmijëve, një departament, por në atë kohë quhej "Redaksia e fëmijëve", një redaksi shumë interesante, shumë e dashur dhe që kishte një vlerë të jashtëzakonshme, sepse ashtu e pamë të gjithë ne që kemi punuar.

Më pas cikli im në Radio Tirana ka vazhduar si gazetarë realizuese e programeve të ndryshme, duke përfshirë të gjithë harkun kohor nga emisionet e mëngjesit, emisionet e paradites, emisionet e mbrëmjes, gjithmonë, siç e thashë, duke qenë pjesë e këtyre gazetarëve të rinj, të cilët po zhvillonin veten dhe njëkohësisht institucionin.

Karriera ime në Radio Tirana ka përfunduar si drejtoreshë e kanalit të dytë në këtë radio. Dua të kujtoj këtu se kanali i dytë i “Radio Tiranës” në kohën kur jam larguar, flas për vitin 2001, ishte thjesht një kanal në dëgjim vetëm të një muzike. Kështu që e gjithë përpjekja ime dhe e stafit, të cilin unë drejtoja, pra në detyrën e drejtoreshës së kanalit të dytë, ishte për ta reformuar. E theksoj këtë disa herë, sepse në përgjithësi në të gjitha mediet që kam punuar, kam dashur që këto medie të zhvillohen, të kenë ide krijuese, të kenë ide novatore, të kenë një mundësi për të zhvilluar mendimin e lirë dhe, njëkohësisht, për të zhvilluar edhe kulturën e debatit.

Përvoja ime më pas ka qenë në disa medie të ndryshme, si në revistën “Kult”, ku unë kam mbajtur postin e kryeredaktores. Kjo ka qenë një revistë, e cila i jepte zë të gjithë kulturës shqiptare të kohës, u jepte zë arteve dhe gjinive të ndryshme dhe përfundonte me një çmim për artistin më të mirë të vitit. E theksoj këtë gjë, sepse jo vetëm kam qenë thjesht një kryeredaktore, e cila mbledhje dhe zhvillonte të gjitha informacionet që vinin në redaksi, por, njëkohësisht, kam qenë pjesë e këtyre debateve televizive që bëheshin për çmimet “Kult”, duke i ideuar ato, duke menaxhuar dhe formatet *talk show* në Televizionin Shqiptar.

Një eksperiencë tjetër shumë e bukur dhe e rëndësishme ka qenë në gazetën “ABC”, e cila ishte një gazetë e përjavshme. Më lejoni të them se ishte e përjavshmja e parë me ngjyra që mundësohej në tregun shqiptar me një skuadër shumë të mirë gazetarësh nga të cilët, natyrisht, që kam mësuar. Më duhet të them se në të gjithë përvojën time nuk jam ndalur vetëm në drejtimin apo vetëm në zhvillimet medietike në Shqipëri, por, njëkohësisht, kam qenë dhe vazhdoj të jem pjesë e organizatave të ndryshme medietike dhe shkëmbimeve kulturore, kryesisht në Ballkan, sepse, siç ju thashë pak më parë, jam një njohëse shumë e mirë e Ballkanit, e zhvillimeve medietike në Ballkan, njëkohësisht, jam një njohëse shumë emirë edhe e kulturës ballkanike. Ndoshta ky mund të jetë një nga elementët që besoj dhe do të dëshiroja shumë, nëse ju do të ma jepnit këtë mundësi që unë të jem anëtare e këtij Këshilli të nderuar të RTSH-së, të shihej si një element shumë i rëndësishëm i këtyre shkëmbimeve kulturore, që sot besoj si i mungojnë Televizionit Shqiptar.

Tjetër gjë që do të doja të thosha, duke qenë se ky është një institucion, i cili, siç e thashë pak më parë, më ka rritur nga ana profesionale, e ndiej si një detyrim, pas një karriere të gjatë pothuajse 30-vjeçare në fushën e medias dhe jo vetëm në fushën e medias, që unë të jap kontributin tim për këtë institucion, i cili, për hir të së vërtetës, vitet e fundit e kemi parë të bjerrë. Unë e kam lënë këtë institucion le të themi në pikën e tij kulmore në vitin '99, kur ishte lufta e Kosovës. Më

duhet ta theksoj këtë gjë, sepse ne kemi qenë pothuajse të parët për lajme, kemi qenë të parët për mundësinë që u jepnim rrëfimeve të kosovarëve dhe gjithçka që lidhej me gjenocidin që ndodhi në Kosovë dhe më vjen shumë mirë që pothuajse ishim në garë edhe me medie shumë të rëndësishme, siç ishin *Deutsche Welle* dhe BBC-ja në atë kohë dhe korrespondentët e tyre, të cilët ishin kolegët tanë në Tiranë, gjë të cilën sot unë nuk e shikoj në këtë institucion, sepse shikoj se ka humbur gara, ka humbur rivaliteti, ka humbur konkurrenca e mirë dhe ka humbur ai brez i mirë i gazetarëve, të cilët me kapacitet e tyre do ta zhvillonin këtë institucion. Prandaj, edhe një herë theksoj dhe mendoj se eksperiencia ime do të jetë një gur ose do të jetë një ndihmesë për këtë Këshill të RTSH-së, ku së bashku me kolegët e tjerë të nderuar, do të kemi mundësi t'i japim atë që meriton.

Nëse do të më duhet të ndalem për të folur për Televizionin Shqiptar, nga mënyra se si e shikoj unë, gjëja e parë që do të doja të thosha është se dua të shikoj një Radiotelevizion Shqiptar Publik në zhvillim e sipër. Kjo do të thotë se sot në Radiotelevizionin Shqiptar mungon diversiteti i programeve, mungojnë shtresat e ndryshme të shoqërisë, të cilat mund ta shikojnë veten të pasqyruar në këto programe. Do të jap një shembull shumë të thjeshtë në pak sekonda.

Në vitin 2019 është nënshkruar një marrëveshje midis shoqatës së personave që nuk dëgjojnë dhe Kuvendit të Shqipërisë, e cili u mundëson 39 mijë personave që nuk dëgjojnë, në të gjithë vendin, të kenë akses në informim. Kjo do të thotë se Televizioni Publik Shqiptar për herë të parë bëri të mundur që kategoria e njerëzve që nuk dëgjojnë të kishin akses në informim, por kjo nuk është e mjaftueshme. Kontaktet e mia dhe punët e përbashkëta që kemi pasur me këtë shoqatë kanë bërë të mundur që gjatë kohës së pandemisë dhe tërmetit, të kemi pasur shkëmbime edhe me disa prej anëtarëve për të arritur këtë akses në informim, i cili në momente krize dhe në momente emergjence ka qenë mëse i domosdoshëm. Të gjithë e dimë se si në konferencat për shtyp, në të gjitha vendet europiane, pikërisht përkthyesi i gjuhës së shenjave ka qenë i përfshirë dhe i domosdoshëm.

E nisa nga kjo, duke qenë se është një eksperiencë imja dhe ndoshta një nga përpjekjet që unë së bashku me stafin tim kemi bërë në kod mundësimin e këtij akses në informim, por të njëjtën gjë shikoj edhe për shumë shtresa të tjera të shoqërisë, të cilat nuk gjenden të përfshira.

Radiotelevizionit Shqiptar sot i mungon prekja me periferinë, e cila është shumë e rëndësishme, sepse më pëlqen të them një shprehje të Hans Bogotas, i cili thotë: “Periferitë

gjithmonë shtyjnë drejt qendrës, ndoshta ndonjëherë edhe në rrugë jo shumë të drejta, edhe në “rrugë të shtrembërta”, - i quan ai, “gjithsesi ato duhet të mbërrijnë në qendër”.

Pra, për të pasur një institucion të fortë, të fuqishëm, një institucion jo thjesht i pari në informim, por gjithëpërfshirës, kemi nevojë për këtë gjithëpërfshirje.

Sot shikoj që këtij institucioni i mungojnë emisionet hulumtuese, emisionet investigative dhe njeriu i thjeshtë. Kemi ardhur ndoshta në pikën kur formatet *reality*, formatet argëtuese, duhet të jenë kryesisht prezente jo vetëm në këtë institucion publik, por njëkohësisht edhe në shumë institucione të tjera.

Gjëja tjetër, për të cilën do të doja shumë të luftoja dhe të përpiqesha bashkë edhe me kolegët e tjerë, nëse ju do të ma jepni këtë mundësi, do të ishte edukimi përmes kulturës. Uënë besoj shumë te kultura. Besoj se kultura është elementi më i rëndësishëm i një shoqërie. Një shoqëri e pakulturuar, e cila ka ...

Mirela Kumbaro – Ju lutem, do t’ju kërkoj të respektoni afatet kohore, sepse kemi edhe kolegë të tjerë, të cilët po presin në linjë!

Respektoni afatin dhe përpiquni ta përmyllni!

Milena Selimi – Dakord.

Faleminderit!

Doja të thosha se edukimi përmes kulturës është një nga elementet më të rëndësishme, çka do të doja shumë ta shikoja në këtë institucion publik. Pse e them këtë gjë? Në jetën e një shoqërie, ndoshta një mandat 3-vjeçar nuk është shumë i rëndësishëm për të bërë ndryshimin, ndoshta do të duhej më shumë kohë, por në jetën e një individi 3 vjet janë shumë, më besoni, sepse janë vite që bëjnë dallimin midis kalimit nga fëmijëria në adoleshencë, nga adoleshencia në një moshë tjetër.

Për këtë arsye mendoj se ky institucion publik duhet të ketë patjetër të gjitha formatet e tij, të cilat bëjnë të mundur dialogun publik, bëjnë të mundur dialogun social dhe në një farë mënyre do t’i krijoni këtë mundësi dhe këtë aftësi të rinjve, që ta shikojnë veten gjithëpërfshirës.

Diçka tjetër, që është shumë e rëndësishme ...

Mirela Kumbaro – Nuk mund t’ju lejoj të flisni më gjatë, sepse jeni tej kohës së dedikuar. Edhe dy fjali, ju lutem!

Milena Selimi – Diçka tjetër shumë e rëndësishme është rrespektimi i traditës. Radiotelevizioni Shqiptar ka një fond arkivi të jashtëzakonshëm, i cili sot është ende i padigjitalizuar, sepse është në bobinat e dikurshme, që quhen “bobinat apeks”, dhe ndoshta do të

duhet që kjo pasuri kombëtare të bëhej e ditur, të bëhej e mundur dhe t'u kalonte brezave për të kuptuar edhe ata se çfarë ka pasur dhe çfarë ka ndodhur.

Mirela Kumbaro – Faleminderit për prezantimin, zonja Selimi!

Para se të kalojmë në pyetjet, që mund të kenë kolegët, edhe për procesverbal, dua të bëj me dije se na është bashkuar kryetari, zoti Ramazan Gjuzi, edhe me figurë.

Faleminderit, kryetar!

Të urojmë shërim të shpejtë!

Urimin jua bëjmë në mungesë, por po e bëjmë edhe drejtpërdrejt!

Gjatë mbledhjes na janë bashkuar zonja Lindita Nikolla dhe zonja Adelina Rista.

Nuk besoj se harrova njeri.

Mund të vazhdojmë me mbledhjen.

Të nderuar kolegë, kush ka pyetje për zonjën Selimi?

Po, zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Zonja Selimi, ju dëgjuam, por nga viti 1990 deri tani, ky televizion publik nuk ka asgjë të mirë në reformën totale që ka bërë, në përmirësime teknologjike? Prezantove vetëm anën e zezë dhe mangësitë, pra asgjë të mirë nuk ka?

E dyta, mjafton vetëm eksperiencia juaj për ta reformuar, ku është “thembra e Akilit”?

Milena Selimi – Faleminderit për pyetjet zoti Beqiraj!

Ajo që u përpoqa t’ju them është se, natyrisht, nuk ndodhem këtu për t’ju thënë vetëm të mirat dhe se çfarë ka ndodhur me reformën në Radiotelevizionin Shqiptar, se është pikërisht Radiotelevizioni Shqiptar ai që bëri të mundur transformimin e medias shqiptare, e cila ka ndodhur në vitin 1992. Ajo që unë do të doja si qytetare dhe ndoshta edhe si anëtare, nëse ju do të ma jepni këtë mundësi, është që të shihja një radiotelevizion, i cili të mos ishte thjesht një fasadë; do të doja të shihja një televizion, i cili të mos mburrej që është i pari në lajmin e parë, por njëkohësisht të bëjë të mundur mbrojtjen e këtij lajmi. Ajo që po shohim sot është pikërisht rendja pas lajmeve, ndoshta pa vërtetuar edhe burimin e lajmeve që na vijnë, prandaj mendoj që kjo është detyrë e këtij institucioni, i cili duhet të jetë gjithëpërfshirës.

Siç jua thashë pak më parë, në Radiotelevizionin Shqiptar janë bërë reforma të thella, por nuk duhet të harrojmë se aty ndodhet një kontingjent krijuesish dhe artistësh, të cilët janë lënë në vijën e dytë, duke mos pasur mundësi që ndër vite ta shfaqin veten e tyre. Kjo do të thotë se kemi një radiotelevizion, i cili po përpiqet që të mos hyjë në brendësi dhe në thellësi të problemeve, por

po përpiket pak a shumë për hir të asaj, të cilat ne mund t'i quajmë formate televizive, ndoshta duke pasur këtu edhe eksperiencën e medieve private të jemi edhe ne si ata.

Ky nuk është roli i Radiotelevizionit Shqiptar, por roli i tij është që të investojë në kulturë, roli i tij është që të vazhdojë traditën, por njëkohësisht t'u sjellë emocione edhe njerëzve të thjeshtë, pikërisht atyre njerëzve, të cilët nuk janë të suksesshëm, por mund të bëhen të tillë falë punës së tyre që bëjnë nëpër zonat ku ata jetojnë.

Faleminderit!

Mirela Kumbaro – A ka kolegë të tjerë që duan ta marrin fjalën?

Nuk shoh ndonjë kërkesë.

Ju falënderoj zonja Selimi për prezantimin dhe përgjigjen e pyetjeve!

Mund të largoheni.

Kalojmë të kandidati tjetër.

Në linjë është zoti Albert Minga.

Fjalën e ka zoti Minga, për prezantimin e platformës së tij.

Ju lutem, hapeni mikrofonin!

Albert Minga – Faleminderit!

Dua t'ju bëj një prezantim të shkurtër. Quhem Albert Minga. E kam nisur karrierën time nga Akademia e Arteve direkt në Radiotelevizionin Shqiptar me detyrën e regjisorit. Është një periudhë e gjatë, me shumë arritje, por edhe me mangësi, të cilat lidhen me kohën, me atmosferën, me krijimtarinë e të tjera, për të cilat nuk dua të zgjatem.

I kam provuar të gjitha gjinitë e televizionit, duke filluar që nga kronika e thjeshtë e duke vazhduar me spektakle të ndryshme të televizionit, me dokumentarë, me teledramën, me filmin artistik dhe më pas me gjininë në të cilën futen të gjithë komponentët në një mënyrë më profesionale dhe më të thellë, serialin.

Ka qenë një periudhë e ngjeshur me shumë punë dhe ajo që dua të theksoj është, në këtë rast flas edhe në emër të kolegëve të mi, se këto vite pune dhe eksperience ishin një mundësi e madhe për të mësuar profesionin dhe për ta prekur vërtet televizionin.

Njëkohësisht, gjatë karrierës sime kam pasur mundësi që profesionin e regjisorit ta ushtrojë në një gamë më të gjerë, duke mos u kufizuar vetëm me regjinë televizive, por duke u marrë edhe me regjinë e teatrit dhe me regjizurën e filmit kinematografik. Në të gjitha këto aktivitete kam

marrë shumë kënaqësi, ndoshta nuk është e udhës t'ju them vlerësimet që janë marrë në mënyrë institucionale pothuajse në të gjitha aktivitetet.

Është fare normale dhe e ligjshme të lindë pyetja: përse kam shfaqur dëshirën për të qenë pjesë e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit?

Kjo ka ardhur për një arsye fare të thjeshtë, duke u nisur nga logjika dhe biografia e punës sime. E njoh në themel punën e Radiotelevizionit Shqiptar, njoh të gjitha specialitetet me të cilat ndërtohen programet e tij, njoh teknologjinë, njoh legjislacionin, sepse kam pasur fatin që për një periudhë të mirë të isha në grupin e punës kur është bërë transformimi nga Radiotelevizioni Shtetëror në Radiotelevizionin Publik.

Po ashtu, më duhet t'ju them, për të qenë realist dhe i ndershëm, mendoj se me këtë ndryshim të madh që ka pësuar në përgjithësi media në Shqipëri, edhe Radiotelevizioni Shqiptar, pa diskutim ka ndryshimet e tij për mirë, sidomos vitet e fundit do ta quaja goxha pozitive krijimin e mundësive për krijuesit, të cilët kanë mundësi të shprehen në disa kanale televizive, të cilat unë do t'i barasvlerësoja me një stacion televiziv privat. Kjo u jep mundësi krijuesve që të shpërfaqin vlerat e tyre. Është e natyrshme që me këtë zhvillim teknologjik edhe për arsye objektive, edhe subjektive, me gjithë zhvillimet e veta, RTSH-ja nuk ka arritur aty ku e kërkon stadi i medias radiotevizive. Madje në një drejtim do të thosha që mund të ketë bërë edhe hapa mbrapa. Për shembull, nisur edhe nga fakti që jam krijues, shoh se në drejtim të produkteve, që kanë të bëjnë me botën e spektaklit, çuditërisht RTSH-ja është e fundit.

Po marr vetëm një program, që ka qenë program klasik i RTSH-së, Varieteja. Ai ka qenë program i suksesshëm, ku janë angazhuar skenaristët, humoristët, regjisorët, aktorët më të mirë, të cilët një pjesë e tyre sot aktivizohen në televizionet private. Paradoksi është që ky program, me kapacitetet që ka RTSH-ja, ka një orkestër fantastike, që ka instrumentistë të shkëlqyer, për nevoja praktike të televizionit mund të krijojnë orkestër, është ndërprerë dhe është çudi e madhe, ndërkohë që disa televizione private mund të themi që kanë tre ose katër trupa që merren me këtë aktivitet.

Po ashtu më duket e padrejtë që në ekranin e televizionit shqiptar është zhdukur teatri. Transmetohet në mënyrë spontane, jo si rezultat i një logjike, e cila është e futur në mënyrë normale me strukturën e vet. Pra, mungon një aktivitet i rëndësishëm, siç është teatri. Unë do të thosha që, nëse do të merren seriozisht me teatrin, këtu mund të eksperimentohet për regjisorët që, siç kemi punuar edhe ne, ku nëpërmjet spektakleve teatrore kaluam tek teledrama, duke u rritur profesionalisht kaluam te filmi serial.

Unë mendoj se duhet të jemi realistë. Çfarë ka televizioni, e ka televizioni, çfarë ka struktura në përgjithësi ose, të themi legjislacioni dhe dispozitat ligjore, mund t'i kenë ato, por ka diçka që duhet të lëvizë në këtë drejtim. Është e çuditshme, por krijuesit më të mirë që janë sot në tregun televiziv në vendin tonë, flas për atë privat, janë produkte të shkollës së RTSH-së. Është një zgjedhje e tyre, sigurisht. Ne duhet t'i bëjmë pyetje vetes se nga një televizion, i cili ka struktura të qarta, përse duhet të largohen? Ndoshta për të mos u neglizhuar është edhe pagesa. Prandaj them se mbase duhet liberalizuar vlerësimi për gazetarët dhe regjisorët, gjithmonë duke pasur parasysh që krijimtaria elitare të vlerësohet dhe t'i japë televizionit një impuls të madh.

Një merak tjetër, që mendoj se është një dritare e mirë dhe mund t'i japë impulse të mëdha jo vetëm RTSH 1-shit, por në përgjithësi të gjithë korporatës së programeve televizive, është aktivizimi i arkivit të RTSH-së. Askush, pa dashur të fyejë njeri, nuk e di se çfarë perlash, se çfarë mrekullish ka arkivi i RTSH-së. Problemi është te krijimi i mundësive financiare dhe teknologjike për të bërë të mundur që ky program fantastik të rimëkëmbet, të aktivizohet. Është një pasuri e madhe, sepse aty duket Shqipëria vizuale, duke filluar nga kronika e thjeshtë, po themi edhe nga jeta parlamentare, nga qytetarët e zakonshëm, nga filmat, nga krijuesit, nga të gjithë, pra janë me mijëra e mijëra programe, të cilat për mua ky duhet të jetë një nga objektivat kryesorë të RTSH-së.

Për t'u rritur cilësia e punës mendoj se duhet të përmirësohet ndërveprimi i RTSH-së me institucionet qendrore. Me këtë kam parasysh Teatrin Kombëtar dhe në përgjithësi teatrot nëpër rrethe, janë goxha trupa, mendoj se ato duhet të jenë ligjërish dhe janë ligjërish, por kanë pengesa, të cilat duhet të kenë bashkëpunim e tyre. Kemi Teatrin e Operës dhe Baletit, apo jo, janë të gjitha këto institucione, të cilat mbahen nga fondet publike, që duhet të jenë bashkëpunëtorët më të ngushtë të Televizionit Shqiptar.

Për vetë strukturën e shumë programeve artistike që ka dhe që duhet të ketë Radiotelevizioni Shqiptar, unë jam për të ngritur kultin e regjisorit dhe të skenaristit, jo thjesht tw gazetarit, në kuptimin e ngushtë pëgorativ, që merret me detyra organizative e të tjera, regjisorit është figura numër 1. Në qoftë se Radiotelevizioni Shqiptar do të ringrejë edhe një herë varietenë, do të thotë që do të ketë një regjisor, i cili, në mënyrë të përjavshme, do të përgatisë aktorët, do të gjejë bashkëpunëtorin me skenaristin, skenografin e të tjera. Mendoj që ky lloj bashkëpunimi do t'i rrisë vlerat televizionit.

Ju kërkoj ndjesë, se e zgjata, por do të doja të thosha edhe një rast jashtëzakonisht interesant. Ka që në datën 23 shkurt që ka nisur *online* një festival mbarëkombëtar i teatrit. Në konceptin tim si regjisor është pak i çuditshëm një festival teatro mbarëkombëtar, cili nuk bëhet në mënyrë të barabartë për të gjitha trupat. Shoh që edhe ashtu siç është, është një gjë pozitive, që i jep dinamikë dhe tregon që teatri rron, por në qoftë se ka një institucion, i cili mund ta organizonte këtë gjetje jashtëzakonisht interesante, është Radiotelevizioni Publik, i cili ka në strukturën e vet kanalet e veta, me kamerat e veta dhe në këtë mënyrë do të bëhej një festival shumë interesant, sepse nuk mund të vlerësohet një trupë teatrore...

Mirela Kumbaro - Zoti Minga, ju kërkoj ndjesë, por, ju lutem, të respektojmë afatet kohore, sepse janë edhe kolegët e tjerë që presin dhe axhenda nuk na lejon të zgjatemi!

Duke kërkuar edhe mirëkuptimin tuaj, ashtu siç e bëra edhe me zonjën Selimi, ju kërkoj ta përmbyllni, para se t'ua japim fjalën kolegëve për pyetje, që mund t'ju japë mundësinë të shtojmë edhe ndonjë gjë tjetër.

Albert Minga – Modestisht, me eksperiencën e punës dhe me njohjen që kam në përgjithësi dhe konkretisht me të gjitha strukturat e Radiotelevizionit Shqiptar, mendoj se ,në qoftë se do të gjykohet si e drejtë nga ana juaj, do të jap një kontribut të vlefshëm në përmirësimin e punës në Radiotelevizionin Publik të Shqipërisë.

Mirela Kumbaro - Faleminderit, zoti Minga!

Faleminderit, për prezantimin!

Zoti Ulqini, fjala për ju.

Musa Ulqini – Faleminderit!

Është kënaqësi shumë e madhe që një njeri me të cilin kam bashkëpunuar shumë vite, siç është zoti Minga, të jetë kandidat. E përshëndes!

Është lajm i mirë besoj për RTSH-në, një njeri që e njeh shumë mirë mënyrën se si funksionon RTSH-ja, njeri që ka kontribuar në pasurimin ligjor të RTSH-së, por, mbi të gjitha, ajo që çmoj shumë te zoti Minga është dashuria e madhe për RTSH-në edhe kur e kritikon, por edhe kur e lavdëron. Është një cilësi e tij, që tregon se është i lidhur kaq shumë me këtë institucion. Zoti Minga duhet përshëndetur!

Duke qenë shumë pozitiv ndaj jush, kam një pyetje: ju me të drejtë ngrini çështjen e një pasurie shumë të madhe, siç është arkiva, për ta kthyer atë në një pasuri të përdorshme sot për RTSH-në. 5 vjet rresht drejtuesit aktualë të RTSH-së kanë sjellë projekte dhe kanë kërkuar nga

komisioni ynë që, në bazë të ligjit, të financohet ajo që thoni ju, dhe 5 vjet rresht ka dështuar 100% çdo kërkesë e ekipit menaxhues të RTSH-së jo në komisionin tonë, por në Komisionin e Ekonomisë, që të marrë fondet për dixhitalizimin e arkivës, sepse, sipas nenit 116 të ligjit “Për mediat elektronike në RSH-së” projektet e rëndësishme teknike për futjen e teknologjive të reja për prodhim dhe transmetim, siç është rasti për të cilin citova ligjin për arkivat, financohen nga buxheti i shtetit. Pra, 100% të financohet nga buxheti i shtetit. Kjo kërkesë është bërë për 5 vjet rresht dhe asnjëherë s’është bërë e mundur të realizohet. A mund të më thoni si mendoni ju që këtë dështim të ekipit menaxhues të RTSH-së dhe Komisionit tonë të Ekonomisë, ju ta ktheni në favor, sepse absolutisht është shumë e rëndësishme që kjo pasuri e madhe, që është arkiva, të jetë një pasuri në funksion të transmetuesit të sotëm të RTSH-së?

Faleminderit!

Albert Minga – Më vjen mirë që e mbështesni këtë argument!

Unë mendoj që gjërat duhen thënë me realizëm dhe duhen vlerësuar, duke i dhënë gjithkujt atë që i takon. Në këtë rast mendoj se më shumë se “lufta” që duhet të bëjë vazhdimisht Drejtoria e Përgjithshme e RTSH-së, këtë luftë duhet ta bëni edhe ju, si Komision i Medias, edhe parlamenti, duke vlerësuar në dramacitetin e vet. Unë nuk dua ta zmadhoj, por dua të vë gishtin mbi plagë dhe të them këtë gjë, që zhdukja e arkivit të mrekullueshëm (e di pse them kështu, i dashur Musa? Sepse edhe unë, ndër të tjera, modestisht kam dhënë kontributin tim në pasurimin e këtij aktiviteti, kam qenë dëshmitar okular me kamera ku janë regjistruar ngjarje dhe histori), nuk do të kemi mundësi të dokumentojmë vizualisht atë që ka kaluar vendi ynë i dashur, që quhet Shqipëri.

Unë them që duhet një mbështetje e jashtëzakonshme nga Kuvendi dhe nga të gjitha institucionet. Ndoshta duhet të jetë një zë i veçantë, specifikisht i veçantë, sepse vërtet kjo kërkon buxhet, por që me rimëkëmbjen e arkivit do të shpëtohet një gjë jashtëzakonisht e madhe.

Mirela Kumbaro - Shumë faleminderit, zoti Minga, për prezantimin dhe përgjigjen e pyetjeve!

Ju uroj ditë të mbarë!

Më lejoni të kaloj te kandidati tjetër, duke u kërkuar ndjesë kandidatëve të tjerë për vonesën!

I lutem kandidatit të radhës, zotit Artan Puto, që të respektojë afatet kohore të parashikuara prej 10 minutash. Kjo vlen edhe për të gjithë kolegët.

Fjala për zotin Puto.

Zoti Artan Puto nuk është në linjë. Fjalën e merr zonja Suela Zalla.

Suela Zalla - Përshëndetje të nderuara zonja dhe zotërinj,

Së pari, dua t'ju falënderoj për mundësinë për të konkurruar si anëtare e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar!

Prej më shumë se 20 vjetësh punoj si regjisore televizive, kinematografike, si aktore dhe së fundi si asistent pedagoge pranë Universitetit të Arteve. Duke qenë pjesë e medias audiovizive që prej themelimit të mediave të para private në Shqipëri, në pozicione të ndryshme pune, gjë që më ka mundësuar njohjen në brendësi të zinxhirit krijues administrativ dhe teknik, shpreh konsideratën time të lartë për një institucion, një mision kaq të rëndësishme sa ai i Radiotelevizionit Shqiptar, i cili është një institucion, të cilin e kam ndjerë pranë vetes që ditën e parë që unë kam shkelur në të, si bashkëpunëtore e jashtme në disa prej programeve letrare dhe kulturore, shumë herët përpara se unë të artikuloja prirjen dhe profesionin që aktualisht ushtroj.

Sot ndihem e plotë që i ofrohem këtij institucioni si kandidate për Këshillin Drejtues të RTSH-së. Kjo më jep besimin se unë mund të jap kontributin tim në këtë institucion, i cili është i të gjithë shtetasve të këtij vendi. Sipas pikës 2 të nenit 93, për përbërjen e Këshillit Drejtues të RTSH-së të ligjit “Për mediat audiovizive në Shqipëri”, mendoj se plotësoj më shumë se gjysmën e kriterëve për të qenë pjesë e këtij Këshilli Drejtues.

Gjatë gjithë këtyre viteve pune intensive në median audiovizive, kam punuar në programe të ndryshme sociale, ekonomike, kulturore, artistike në rolin e ideatores dhe realizueses.

Kam hasur vështirësi të ndryshme dhe problematika të jashtëzakonshme, por ajo ku dua të vë theksin sot është pikërisht barazia gjinore. Unë vij këtu përpara jush sot si një përfaqësuese e shoqatës “Gruaja shqiptare në audiovizual”, shoqatë, e cila në tre vjet ekzistencë, punon dhe lobon çdo ditë për përfaqësimin sa më të denjë të gruas në audiovizual. Shoqata “Gruaja shqiptare në audiovizual” është pjesë e një sërë projektesh sensibilizuese, krijuese dhe artistike, duke pasur si instrument kryesor komunikimi, pikërisht, median audiovizive në të gjitha mundësitë që teknologjia të krijon sot, si pjesë e një zinxhiri të simotrave të saj europiane dhe botërore. Radiotelevizioni shqiptar është institucioni publik më i rëndësishëm i medias audiovizive dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me audiencën, sipas pikës 1 të nenit 91, lidhur me deklaratën e qëllimit në lagjin për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, si një OSHMA e përkushtuar ndaj idealeve më të larta të transmetimit të shërbimit publik kombëtar.

RTSH-ja realizon shërbime cilësore radioje dhe televizioni për të informuar, argëtuar dhe edukuar publikun, duke u shërbyer kombit, të gjitha grupeve dhe shoqërisë, përfshirë këtu edhe pakicat kombëtare.

Dua të theksoj se në kohën kur është shënuar një arritje e madhe me digjitalizimin e RTSH-së dhe të një pjese të rëndësishme të arkivës së tij, duke e bërë atë të aksesueshëm për hapësirën e gjerë të konsumatorit audioviziv në radiotelevizion, i cili është edhe konsumatori më i madh në vend për mediat audiovizive, epokat digjitale sjellin sfida të reja, që nga video *on demande* deri te platformat më konkurruese në internet dhe në këtë fushë sigurisht që ka shumë për të bërë. Për këtë arsye duhen kërkuar ide, prurje të reja, inovative, njerëz me koncepte inovative, që janë në koherencë me kërkesat e tregut dhe të cilësisë artistike, qëllimit për ta edukuar dhe promovuar vlerat kombëtare.

RTSH-ja është makineria më e madhe prodhuese në vend në sektorin audiovizual. Sigurisht që në 16 kanale televizive në total, 3 prej të cilave lokale, siç është RTSH Korça, Gjirokastra dhe Kukësi, dhe 13 të tjera kanale tematike, janë një thesar në duart e teleshikuesit dhe konsumatorit audioviziv dhe komunitetit të interesuar drejtpërsëdrejti për produktin televiziv të RTSH-së. Por ka gjithmonë vend dhe nevojë për përmirësim, ka vend dhe nevojë për prodhime të reja dhe, sipas nenit 124 në pikën 1, për prodhimet e Radiotelevizionit Shqiptar, bashkëprodhimet dhe prodhimi i porositur i programeve, që përbëjnë, të paktën, 50% të kohës së transmetimit, kjo përqindje, në këndvështrimin tim, e prodhimit shqip mund të rritet dhe të realizohet në mënyrë akoma edhe më fitimprurëse përmes trendit aktual evropian dhe botëror që janë...*(Nuk dëgjohet.)* Ne mund ta rrisim përqindjen e prodhimit shqip shumë më tepër përmes bashkëprodhimeve rajonale dhe evropiane, mekanizma, të cilat të eksplorojnë nëpërmjet *Creative Europe* dhe televizioneve rajonale dhe atyre evropiane të paeksploruara akoma deri tani. *Creative Europe* është drejtpërsëdrejti e interesuar për t'i mbështetur prodhimet kombëtare, më qëllimin e vetëm për t'i ruajtur dhe për t'i promovuar vlerat kombëtare në familjen e madhe evropiane. Vazhdon të përbëjnë interes për *Creative Europe* dhe për të gjithë audiencën evropiane kulturat kombëtare, kulturat e veçanta. Unë jam e sigurt që kultura shqiptare është një pasuri më vete në të gjithë këtë tablo dhe në të gjithë këtë hartë të madhe të Bashkimit Evropian. Këtë politikë po e ndjekin shumë vende të Europës, të cilat aktualisht e kanë rritur në mënyrë të ndjeshëm prodhimin kombëtar audioviziv.

Të gjithë drejtuesit e Radiotelevizionit Shqiptar mund të ndihmojnë në rritjen e kësaj përqindjeje të prodhimit vendas, siç parashikohet në nenin 91, në pikën 1, në lidhje me deklaratën e qëllimit. Pra, si një OSHMA e përkushtuar ndaj idealeve më të larta të transmetimit të shërbimit publik kombëtar, RTSH-ja realizon shërbime cilësore në radio dhe në televizion për të informuar, për të edukuar dhe për të argëtuar publikun, duke i shërbyer kombit të të gjitha grupeve të shoqërisë, duke përfshirë edhe pakicat kombëtare. Audiencia shqiptare ka nevojë urgjente të dëgjojë shqip. Ata kanë nevojë për filma dhe seriale televizive në gjuhën shqipe, duke marrë parasysh fluksin e madh të serialeve e të filmave në gjuhë të huaj të ofruara nga operatorët privatë. Mungesa e këtij produkti vendas ka krijuar një uri të madhe te konsumatori, te audiencia dhe, për këtë arsye, është detyrë e RTSH-së ta përmbushë këtë uri të madhe të audiencës. Në thelb, është krijuar një humnerë ndërmjet publikut dhe produktit audioviziv shqipfolës. Kjo uri është edhe qëllimi i ekzistencës së motorit më të rëndësishëm audioviziv në vend, sipas nenit 91, pikës 3 të tij. RTSH-ja realizon programe, të cilat duhet të pasqyrojnë tedëgjuesit dhe shikuesit e të gjitha moshave larminë e jetës shqiptare. Pra, përgatit programe cilësore me vlera për pasurimin e botës mendore dhe shpirtërore të njerëzve. Dua të theksoj se ky është misioni i vërtetë i një anëtari të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar. Sipas nenit 101, pika “a”, pra detyrat e anëtarëve të Këshillit Drejtues, ata do të përfaqësojnë interesat e shikuesve dhe të dëgjuesve. Mospërkatësia politike, gjithashtu, është një ndër pikat më të rëndësishme, ku duhet t’i mbështesim energjitë tona, në zbatim të pikës 2 të nenit 91 të RTSH-së, e cila zotohet për një mbulim të paanshëm të lajmeve të vendit dhe atyre ndërkombëtare.

E shikoj si një detyrë dhe si një sfidë të çdo anëtari të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar, si është organi më i rëndësishëm vendimmarrës, mbajtjen larg nga politika të këtij institucioni, si më i rëndësishmi në vend.

Radiotelevizionit Shqiptar i detyrohet audiencës së tij paanësi politike dhe fetare, duke bërë që kjo audiencë të ndihet e barabartë përballë... *(Nuk dëgjohet.)*, për të cilin paguan njësoj, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 4, pra parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve televizive, si dhe nenit 102 në lidhje me kompetencat e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

Zonja dhe zotërinj, siç kam përmendur më lart, barazia gjinore në vendimmarrje është detyrë e shoqërive të emancipuara. Barazia gjinore mund të vijë përmes kuotave të paracaktuara në ligjin “Për barazinë gjinore”, por ajo mund të vijë edhe si një nevojë organike e kohës ku jetojmë. Ne kemi nevojë të përfaqësohemi, zëri i grave dhe i vajzave, që kanë vite që punojnë në

sektorin audiovizual, duhet të jetë aq i fortë sa ai i gjinisë tjetër dhe për këtë arsye unë apeloj shumë fort në vëmendjen tuaj për zgjedhje e kandidatëve gra dhe vajza.

Faleminderit!

Mirela Kumbaro – Faleminderit, zonja Zalla!

A ka pyetje nga kolegët? Nuk ka.

Dakord.

Faleminderit, zonja Zalla, për prezantimin! Jeni e lirë.

Faleminderit!

Kalojmë te kandidati tjetër. A është rikthyer zoti Puto? Po.

Atëherë, më lejoni t'ia jap fjalën zotit Artan Puto për prezantimin e tij.

Zoti Puto, keni fjalën. Më lejoni t'ju kujtoj respektimin e kohës, pra afatin 10 minuta të prezantimit, jo për fajin tuaj, por tashmë është akumuluar pak vonesë.

Faleminderit!

Artan Puto – Faleminderit për ftesën që më bëtë për të marrë pjesë në këtë bashkëbisedim!

Unë dua të prezantohem. Quhem Artan Puto, jam pedagog i historisë së Shqipërisë në Departamentin e Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës.

Arsyeja që më shtyu të kandidoj për anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar, së pari, është arsyeja profesionale, sepse, duke pasur parasysh CV-në time profesionale dhe eksperiencën e punës, mendoj se kryqëzohen një sërë aktivitete. Domethënë, nga sfera studimore universitare, më pas jam marr me aktivitete kulturore dhe në gjysmën e dytë të viteve '90 dhe në fillimin e viteve 2000 kam qenë i përfshirë edhe në aktivitete si gazetar. Arsyeja tjetër, e cila më ka shtyrë për të shprehur një interes në lidhje me RTSh-në, është se, për fat të mirë, ka disa kohë që e ndjek, kam përshtypjen se RTSH-ja është në një rrugë të mbarë drejt shndërrimit të saj në një mjet të informimit publik. Pra, ndryshe nga çfarë jemi mësuar që ta shikonim RTSH-në disa vite më parë, qoftë kur ishin në fuqi partitë e majta, ose partitë e djathta, kur RTSH-ja ishte më shumë një propagandues politik tani shoh me kënaqësi që është në një rrugë të mbarë.

Nuk e di sa kohë kam, por mund t'ju shpjegoj se cili është ky impression. Ka të bëjë, në radhë të parë, me informacionin që ajo jep, ka një strukturë që për mendimin tim është shumë e kuilibruar dhe ëshë më e pranueshme nga publiku sesa një varg televizioneesh të tjera private kombëtare, nga ana tjetër shoh me kënaqësi që ka në përbërjen e saj edhe emisione, që janë kritike

ndaj politikave qeveritare. Mund të përmend këtu një emision investigativ, që më ka bërë shumë përshtypje, që quhet “31 minuta”, ose emisione që kanë tematikë ekologjinë dhe mjedisin, që janë tema të ditës. Pra, shoh që po jep një shembull pozitiv në drejtim të shndërrimit të saj në një mjet të informimit publik. Patjetër që ka shumë punë për të bërë për ta përmirësuar dhe shumë modestisht mund të them që, nisur nga eksperiencia ime si historian edhe si anëtar i një departamenti, që merret me trashëgiminë kulturore, mund të shihet mundësia e dhënies së informacioneve më shumë të lidhura më historinë e Shqipërisë me trashëgiminë kulturore, por këtu do të bëja një vërejtje, gjithmonë duke pasur parasysh ato që kam parë në lidhje me emisionet me karakter të tillë. Ndoshta është një jehonë e së kaluarës. Do të thotë që sa herë ne shfaqim dokumentarë në lidhje me historinë dhe kulturën e Shqipërisë ne jemi paska etnocentikë, pra çdo gjë rrotullohet rreth të të qenit shqiptar. Në fakt, historia dhe kultura e shqiptarëve duhen vendosur në realitete shumë herë më të mëdha sesa janë kufijtë politikë, ose etnikë, sepse ne e dimë nga historia, dhe kjo është një nga karakteristikat më të spikatura të kulturës shqiptare dhe të këtyre territoreve, ku janë kryqëzuar kultura të mëdha, qoftë kultura greko-romake, ajo bizantine, madje edhe kultura osmane. Të gjitha këto emisione me tema historike, të cilat mund të organizohen, duhet të vendosen në një relitet shumë më të gjerë. Nga ana tjetër, kam dhe një sugjerim, shpeshherë kemi vënë re që këto emisione, të cilat mund ta pasuronin edhe më tepër strukturën e programeve të RTSH-së, duhet patjetër të kihen në kujdesin e profesionistëve të fushës. Shpeshherë shohim që ka moderatorë, ose gazetarë, që nuk kanë shumë lidhje me tematikën për të cilën ata flasin. Unë do të thosha që shoh këtu një hapësirë për përmirësim. Një tjetër temë, që ndoshta ka mbetur gjithmonë në fushën e kulturës, apo që ka mbetur jashtë vëmendjes, është ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe në radhë të parë ajo e arkeologjisë së shpëtimit, të cilën ne e bëjmë. Pse e them këtë? Sepse para disa kohësh pashë një program në edicionin informativ të RTSH-së, që fliste për për një kishë bizantine në bashkinë e Roskovecit. Problemi në lidhje me restaurimin e saj dhe me mirëmbajtjen e saj paraqitej thjesht si një problem që ka të bëjë me bashkinë dhe me Ministrinë e Kulturës. Në fakt, ne duhet të mësohemi, duke u nisur edhe nga parametrat e BE-së që pasuria, trashëgimia kulturore, në radhë të parë, është pronë e komunitetit, pra duhet trajtuar në lidhje edhe me marrëdhëniet që ka publiku me këtë trashëgimi kulturore. Në këtë aspekt mendoj se mund të ketë hapësirë për të përmirësuar programet e RTSH-së, pra për të sjellë një informacion në një frymë më të re, por gjithsesi duhet parë se cilat janë dhe kushtet, ose mundësitë financiare.

Për të mos u zgjatur shumë, se ndoshta nuk ka kohë, këto janë në vija të përgjithshme ajo që desha të them.

Mirela Kumbaro – Shumë faleminderit, zoti Puto, për prezantimin dhe theksimin e asaj që ju mendoni se do të ishte një produkt i drejtpërdrejtë juaji!

Dua t'a jap fjalën kolegëve.

A ka pyetje nga kolegët?

Nuk shoh duar të ngritura.

Zoti Puto, ju falënderoj shunë për prezantimin dhe ju ftoj të largoheni për të vazhduar ditën tuaj!

Artan Puto – Faleminderit!

Punë të mbarë!

Mirela Kumbaro – Po ia jap fjalën kandidatit tjetër në radhë, zotit Thanas Goga.

Përshëndetje, zoti Goga!

E keni ju fjalën për prezantimin e platformës suaj. Më lejoni t'ju kujtoj se afati 10 minuta është shumë strikt dhe nuk duhet tejkaluar, për të mos vonuar edhe kolegët në listë.

E keni ju fjalën, zoti Goga.

Thanas Goga - Mirëmëngjesi!

Shumë faleminderit për ftesën!

Jam shumë i nderuar që m'u dha mundësia të marrë pjesë në seancën dëgjimore për të prezantuar veten, përvojat e mia, si kandidat për anëtar të KDRTSH-së, si dhe të paraqes idetë e mia për zhvillimin e RTSH-së. Si specialist i komunikimeve dhe kërkimeve të medias vij nga një përvojë mbi 22-vjeçare në këtë sektor. E kam nisur rrugëtimin si specialist i komunikimit për zhvillimin e medias që në vitin 1997 me Departamentin e Zhvillimit të Medies në prezencën e OSBE-së në Tiranë ku kam punuar për një periudhë 5-vjeçare. Aty pata mundësinë të përfshihem drejtpërdrejt për herë të parë si përfaqësues i OSBE-së edhe në krijimin rishtazi të KDRTSH-së dhe e kam ndjekur hap pas hapi nga afër në të gjitha mbledhjet e veta, në të gjitha projektet e veta të zhvillimit dhe, le të themi, kam qenë me fat që e kam ndjekur që në krye të herës. Më tej iu bashkova projekteve të tjera dhe programit të zhvillimit të medias të (*nuk kuptohet*) që janë kontraktorë të USAID-it, dhe po ashtu kam punuar me projekte të zhvillimit të medias me BE-në me Këshillin e Europës, me *Inter Euronews*, me SOROS-in e shumë të tjerë.

Së fundi këto 8 vjet kam dhënë kontributin tim si këshilltar i komunikimit për ministrin e Shëndetësisë dhe më tej, për 3 vjet, si ndihmës për komunikimin i Kryeministrit. Sigurisht gjithë kjo përvojë, por edhe formimi im akademik dhe arsimi i nivelit master në Shtetet e Bashkuara, me fokus të veçantë në metodat e studimit të audiencës së medias, që besoj se është një përvojë shumë e kufizuar edhe në Shqipëri, si dhe mësimdhënia prej 12 vjetësh në departamentin e gazetarisë, në Universitetin e Tiranës, më bëjnë të besoj se kam mundësi t'i vendos këto dije në praktikë. Pra, unë besoj fuqimisht në fuqinë e komunikimit dhe në mundësitë që ofron komunikimi për ndryshim, dhe ku ka më mirë se t'i zbatoj të gjitha këto njohuri, dije e përvoja praktike për zhvillimin e RTSH-së.

Në qoftë se do ta përmbledhja me një fjali objektivin e ideve të mia për zhvillimin e RTSH-së, unë them që RTSH-ja duhet të jetë patjetër operatori nr.1 në tregun audioviziv shqiptar, sepse i ka të gjitha mundësitë dhe të gjitha kapacitetet, e ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe, sigurisht, edhe gjithë historikun dhe burimet njerëzore që ta bëjë të mundur arritjen e këtij objekti.

Ku mund të ndihmoj unë specifikisht në këtë drejtim? Besoj se janë katër fusha, që lidhen në mënyrë të veçantë me formimin dhe përvojën time.

Së pari, unë besoj fuqimisht se kemi kapacitete të pashfrytëzuara në këtë epokë të transmetimeve numerike për sa i përket aplikimit të dijeve që kemi qoftë nga studimi i tregut, qoftë nga studimi i audiencës së medias, duke pasur ide më të qarta për informacionin që na vjen nga këto studime, për hartimin e planeve strategjike, për fuqizimin e burimeve të reklamave apo krijimin e formateve më të përshtatshme, që u përputhen nevojave, shijeve dhe kërkesave të audiencës. Unë besoj se ky është një gur i mirë kilometrik për t'u arritur në qoftë se kemi mundësi t'i bëjmë të gjitha këto. Gjithashtu, vënia në praktikë e dijeve dhe e informacionit që marrim prej tyre na ndihmojnë më pas për të bërë një pasqyrim më të gjerë të mundshëm, të një spektri më të madh të interesave të audiencës dhe të të gjithë zërave që kanë nevojë të përfaqësohen në televizionin shqiptar, por, sigurisht, mund të na ndihmojnë edhe në përmirësimin e strukturës programore, mund të vënë në dispozicion formate të tjera transmetimi, që janë ende të pashfrytëzuara me mundësitë që ofron teknologjia e sotme e kështu me radhë.

Së fundi, kjo fushë studimore mund të ndihmojë që të shqyrtohen burime të tjera financimi, përveç taksës, që vjen nga licenca e transmetimit, buxhetit të shtetit dhe reklamës, edhe partneriteti me organizata ndërkombëtare. Këto mund të bëjnë një përshtatje dhe një riorganizim më të mirë

të këtyre burimeve, për një model më të qëndrueshëm ekonomik dhe, le të themi, më të pavarur të zhvillimit të RTSH-së.

Së dyti, e thashë, besoj në mundësitë e pakufizuara që ofrojnë zhvillimet në teknologjinë e sotme të informacionit. Të gjithë jemi dëshmitarë që prej disa vitesh tashmë po provojmë përfitimet dhe mundësitë që ofron transmetimi *on demand* krahasuar me transmetimin linear audioviziv që ne kemi pasur deri para pak kohësh dhe, sigurisht, kjo jep mundësi, së pari, për formate dhe përmbajtje mediatike goxha më të madhe qoftë si sasi, qoftë si cilësi dhe, së dyti, edhe si platformë shpërndarjeje.

Unë besoj se në këtë nivel mundësitë janë të pashfrytëzuara dhe ka një pafundësi mënyrash se si mund të organizosh shërbimin e transmetimeve, se si mund të krijosh ekosisteme të tjera transmetimi, me qëllimin e vetëm jo thjesht për ta rritur si masë numerike audiencën, por për ta angazhuar atë, për ta bërë pjesë aktive të një transmetimi, që është i dykrahshëm, jo më transmetim nga një pikë drejt masave, por një transmetim dhe një komunikim i dyanshëm, ajo që në gjuhën e ekspertëve njihet me termin *engagement*.

Së treti, unë besoj shumë që të gjitha këto zhvillime mund të sjellin një model më të zhdërvjellët dhe më të pavarur ekonomik të Radiotelevizionit Shqiptar, i cili bëhet kusht ose parakusht edhe për të rritur pavarësinë e vet, dhe këtu teknologjia mund të na ndihmojë përsëri me të ashtuquajturat shërbime transaksionale të videos, që janë derivate të shërbimeve *on demand* dhe jo thjesht të kanalit tradicional të shërbimeve lineare të transmetimit.

Së fundi, një pikë ku unë besoj se mund të ndihmoj posaçërisht është menaxhimi, hartimi, mbikëqyrja dhe zbatimi i projekteve për bashkëpunim dhe partneritet me institucionet dhe organizatat e specializuara ndërkombëtare, që ndjekin apo edhe udhëheqin zhvillimet në këtë sektor, siç janë: EBU-ja, OSBE-ja dhe veçanërisht Komisioneri për Lirinë e Medies pranë këtij institucioni, me të cilat kam kohë që bashkëpunoj dhe kam qenë i përfshirë në projekte të ndërsjella, sigurisht, Këshilli i Europës, Observatori Audiovizual dhe shoqatat e ndryshme, që përfaqësojnë interesat e operatorëve publikë qoftë në Europë, qoftë në Shtetet e Bashkuara e më gjerë.

Unë besoj se këto janë mundësi të paeksploruara dhe përveçse janë mundësi zhvillimi dhe mundësi financimi apo mbështetjesh me burime, janë edhe një mundësi për t'u zhvilluar profesionalisht dhe për të eksploruar modele të reja zhvillimi për RTSH-në.

Shkurtimisht, këto ishin katër pikat me të cilat unë besoj se mund të ndihmoj në zhvillimin e RTSH-së.

Mirela Kumbaro - Faleminderit, zoti Goga!

Faleminderit edhe për sportivitetin me të cilin respektuat kohën! E vlerësoj këtë.

Më lejoni t'ua jap fjalën kolegëve, nëse dikush ka ndonjë pyetje për të bërë.

Po, zoti Ulqini.

Musa Ulqini- Vetëm 2 fjali.

E para, zoti Thanas është njeriu që ka dëshmuar pranë komisionit tonë, të paktën për 5 vjet rresht si përfaqësues i OSBE-së, që është një njohës i shkëlqyer i standardeve se si duhet të funksionojë media publike.

E dyta, ajo që dëgjova për herë të parë nga të gjithë kandidatët është televizioni publik i së ardhmes dhe e përgëzoj shumë zotin Thanas për idetë që solli këtu.

Faleminderit!

Mirela Kumbaro - Faleminderit, zoti Ulqini!

Nëse nuk ka pyetje të tjera, zoti Goga, unë ju falënderoj për prezantimin, por edhe për idetë e reja që sollët në prezantimin tuaj! Ju uroj një ditë të mbarë!

Faleminderit, që ishit pjesë e dëgjësave dhe bashkëbisedimit në komisionin tonë sot!

Më lejoni t' i jap fjalën zonjës Luljeta Lleshanaku!

Përshëndetje, zonja Lleshanaku!

Mirë se erdhët!

Luljeta Lleshanaku - Faleminderit!

Po i bie shumë shkurt për biografinë që të merrem me pjesën tjetër të prezantimit.

Quhem Luljeta Lleshanaku. Kam një eksperiencë besoj të mirë në media. Nga viti 1994 deri në vitin 2004 jam marrë me median e shkruar dhe me projekte mbi median. Në vitin 2010-2012 kam qenë autore e programit “Orkidea” në AlbaniaScreen.

Në vitin 2009-2011 kam qenë anëtare e bordit drejtues të Akademisë së Vlerësimit Vjetor Radioteleviziv të krijuar instituti Akt. Dy vjet kam qenë edhe kryeredaktore e revistës “Akt”.

Një tjetër përvojë, besoj që ia vlen të përmendet, është edhe përvoja ime si lektore e skenarit në Akademinë e Filmit dhe të Multimedias “Marubi” në Tiranë. Pjesa tjetër pak a shumë janë librat e mi, pjesa e letërsisë, angazhimi im në Institutin e Studimeve të Krimeve të Komunizmit, në Forumin e të Drejtave të Njeriut, në Forumin e Helsinkit dhe të gjitha këto përvoja bashkë më japin

një lloj të drejte që të ofroj ekspertizën time, njohuritë e mia, përvojën time si anëtare e këtij këshilli.

Për të vazhduar me pjesën më të rëndësishme të prezantimit, pra cili është perceptimi im për televizionin shqiptar dhe cilat mendoj unë se janë ato aspektet kryesore me të cilat duhet të punohet për cilësinë e këtij televizioni.

Pak a shumë situata është e tillë. Me ndryshimet e mëdha të viteve të fundit në media, sfida për transmetuesit publikë është se si të futen artistikisht, strategjikisht në peizazhin e mediave private, vendase dhe mediave globale që janë të mbingarkuara, konkurruese, dominuese, duke u ofruar audiencave zgjedhje, por pa braktisur, në të njëjtën kohë, qëllimin si mjete publike: Të ofrojnë vlera aty ky trendet nuk mundën ose nuk janë të interesuara, që është një sfidë me të cilën po përballen televizionet publike në të gjithë botën, duke përfshirë edhe media që kanë një traditë shumë të gjatë dhe të respektuar në vende me demokraci të zhvilluar siç është BBC-ja, për shembull.

E gjithë strategjia e TVSH-së në bashkëpunim me Këshillin Drejtues, sepse Këshilli Drejtues miraton strategjinë dhe unë e shoh si një organ bashkëpunues, pra duhet të jetë “Si ta bëjnë TVSH-në zgjedhjen e parë të publikut?”. Kjo duket sureale, e pamundur, por unë po jap disa nga aspektet se si e shoh unë dhe mbi të cilat mund të punohet.

Kredibiliteti. Kur flasim për kredibilitet, e para gjë që na bie ndër mend janë lajmet, emisionet informative. Ndodhemi në kushtet e sensionalizimit të lajmit dhe deinstitutionalizimit të medias, duke pasur parasysh lulëzimin e mediave sociale, Facebook-ut, Instagram-it, Twitter-it, blogerëve, pra është e vështirë që TVSH-ja të mund të konkurrojë nëpërmjet shpejtësisë ose përmes joshjes, (flas për natyrën sensacionale të lajmit) për shkak se punë në TVSH rregullohet nga ligji, statuti, standardi etik dhe profesional të detyrueshme dhe të pasqyruara në kontratat e punonjësve dhe në bazën e një udhëzuesi praktik, të cilat janë edhe pjesë e rekomandimeve të BE-së për vendet kandidate.

Në këto kushte, TVSH-së i mbetet të konkurrojë me atë që nuk ofrojnë të tjerët, pra është besueshmëria, që do të thotë se, nëse qytetari ka marrë informacion nga të gjitha burimet e tjera, por ndihet konfuz, i paqartë, ai do t’i drejtohet TVSH-së. Sigurisht, lajmi është i mërzitshëm pa këtë që ju thashë, por do të jetë informacioni, objektiviteti ai që do ta ofrojë, në momente të caktuara sidomos, dhe duke pasur parasysh rëndësinë e lajmit politik, pasi jeta në Shqipëri akoma ngelet shumë e politizuar, merr një rëndësi të dorës së parë.

Po cilët janë aspektet e tjera të kredibilitetit. Janë programet e gazetarisë investigative. Për shembull, para disa kohësh, TVSH-ja kishte një emision të tillë që quhej “Elementi VI”, i cili ishte fokusuar në çështje të mjedisit dhe natyrisht prekeshin interesa të bizneseve të fuqishme. Programi u mbyll, nuk e di arsyen.

Është edhe një program tjetër, “31 minuta”, që ka një sens kritik, megjithëse jo tamam investigativ. Padyshim që fusha investigative është fushë shumë delikate, madje Televizioni Publik Slloven kaloi një krizë se për pak iu prenë fondet publike nga kjo, mirëpo këto janë ekuilibrat e demokracisë dhe një gazetari investigative rrit besueshmërinë, kredibilitetin në audiencë.

Tjetër element shumë i rëndësishëm është cilësia, pra nxitja e ideve dhe energjive krijuese. Realizimi i kalimit nga transmetimet analoge në ato numerikë është një proces me rëndësi kombëtare, po kështu edhe zgjerimi i strukturës me kanale, tematika e të cilave mbulon të gjitha kategoritë dhe të gjitha grupet e interesit është një obligim.

Modernizimi i teknologjisë, i studiove, i videove, gjithashtu, ndihmon, por ndyshimet teknologjike dhe të gjitha ato që thamë më sipër dhe shumëllojshmëria nuk ndikojnë doemos në cilësinë e transmetimit, ajo sjell përmirësimin e cilësisë së transmetimit, duke përfshirë idetë, që janë inovatore, interesante dhe konkurruese në treg. Po ka diçka, që me fjalë të tjera është fakti se TVSH-së i duhet një zhvillim vertikal, jo më horizontal.

Cilat janë pengesat në këtë aspekt?

Ndryshe nga televizionet tjera, televizionet private, me kontrata që ndryshojnë në varësi të pronarit, ne kemi një strukturë burokratike, pra është një strukturë, deridiku më e ngurtë. Kemi një punësim të rregulluar me kontratë të përhershme, gati të përjetshme, që varet nga përvoja e punës dhe shumë elementë të tjerë, ndërsa për një pjesë të stafit kemi edhe kontrata të përkohshme.

Gjithashtu ekziston, dhe kjo ndoshta është pjesa më fleksibël, ku mund të ndërhyhet, fondi për projektet e pavarura, që për mendimin tim është i pamjaftueshëm, i cili mund të shfrytëzohet si një hapësirë e mirë për të sjellë ide të reja, për të futur ajër të freskët, le të themi. Mundësia tjetër është edhe akademia, të cilën e kanë krijuar si departament Televizioni Shqiptar, dhe premtion rritjen e kapaciteteve ekzistuese, që do të thotë përmes workshop-eve, trajnimeve dhe kualifikimit të stafit ekzistues, po për mendimin tim nuk mjafton për të bërë një reformë.

Në këto kushte, e vetmja mënyrë për të përballuar konkurrencën e mediave private, mediave globale përmes cilësisë, është nxitja e konkurrencës brenda institucionit. Puna është si të bëhet kjo nxitje? Si hap i parë do të ishte një monitorim i vazhdueshëm, që mund të ishte çdo

gjashtë muaj, për shembull, mbi shikueshmërinë e programeve. Të testohet produkti përmes vlerësimit të publikut, *exit poll*-eve dhe formave të tjera të testimit.

Kësisoj, jo vetëm që do të kishim një vlerësim objektiv për secilin program, por do të bënte që edhe audienca të ndihej e përfshirë në proces. Të mos harrojmë që është një televizion publik.

Natyrisht, puna e televizionit dhe e radios është të dëgjojnë nga audienca se çfarë duan, por jo se si, sepse kjo është punë e stafëve krijuese të TVSH-së, dhe detyra e TVSH-së është edhe të edukojë shije. Tashmë jemi informuar se çfarë kërkon publiku, pra e marrim parasysh mendimin. Pjesa tjetër pastaj, është pjesë kreative, sepse është detyrë e këtij televizioni të edukojë shije të tjera. Fjala vjen, sot *reality show* është një zhanër shumë i preferuar në të gjithë botën. Jam e sigurtë që, po të bëjmë një *survey* në audiencën shqiptare, rezulton i preferuar, si një nga opsionet më të mira. Pra, mund ta sjellësh këtë zhanër, por me një tematikë krejt tjetër, duke iu larguar banalizimit. Çfarë tematike? Për shembull, mund të ndërtohet një *reality show* që ka si tematikë edukimin përmes punës, edukimin e punës, përgjegjësinë sociale apo ambientaliste, sidomos tek të rinjtë. Pra, gjëra të kësaj natyre.

Gjëja kryesore, është se monitorimi do të sillte edhe reflektim dhe rishikime më të shpeshta të programeve ekzistuese dhe të politikave. Pra, e bën çdo gjë më fleksibël. Mbi të gjitha do të nxiste konkurrencën brenda vetë televizionit. Ajo çfarë mund ta ngrrej cilësinë e televizionit në konkurrencë me medie të tjera, me mediet private, me mediet globale, është rritja e konkurrencës brenda vetë televizionit. Një nga këto është *survey*, sepse duke i prekur në sedrën profesionale, duke testuar vazhdimisht pritshmërinë dhe programin nga audienca, në një farë mënyre ngacmon ambicien profesionale të stafit ekzistues, dhe gjërat fillojnë të lëvizin, pak a shumë. Vetë BBC-ja rinovon politikat çdo dhjetë vjet, për shembull, ndërsa këtu tek ne mund të ndodhë edhe më shpesh se kaq.

Një mënyrë tjetër për të rritur cilësinë, është futja e sistemit të stimujve, gjë që rrit ambicien profesionale, siç mund të jenë çmimet vjetore, bonuset, ngritjet në detyrë. Kjo metodë aplikohet shumë në televizione të tjera, sidomos në perëndim, kështu që edhe këtu do të ndihmonte goxha.

Për mendimin tim, të gjitha këto synojnë një lloj daljeje nga apatia, një lloj dalje nga gjendja e të pasurit të sigurtë të çdo gjëje. Në momentin kur puna e gjithësecilit ndjehet e rrezikuar...

Mirela Kumbaro – Ndjesë, zonja Lleshanaku, por ju lutem, përmbliidheni pak fjalën tuaj, me qëllim që të respektojmë afatin kohor. Ju faleminderit!

Luljeta Lleshanaku – Po ashtu, është dhe shfrytëzimi më i mirë i aseteve të brendshme. Kur flas për asete të brendshme, së pari kam parasysh shfrytëzimin e arkivit së televizionit, sepse është për të ardhur keq që është përdorur nga televizionet e tjera, por nga vetë televizioni shqiptar nuk e ka përdorur si duhet arkivin. Pasuria e arkivit është e jashtëzakonshme, sidomos në gjininë e filmave dokumentarë, por edhe emisioneve të tjera.

Me asete të brendshme kuptoj edhe ata individë të talentuar, tek të cilët ka investuar ky televizion, por që ose kanë kaluar në televizione të tjera, ose i janë nënshtruar një lloj apatie të përgjithshme.

E katërta është zgjerimi i bashkëpunimeve. Këtu flas për zgjerim bashkëpunimesh brenda dhe jashtë Shqipërisë, me televizione të tjera, me institucione të tjera, gjë që zgjeron audiencën dhe krijon mundësinë të krijosh me gjysmë kosto gjëra cilësore, si shkëmbim idesh.

Pra, pak a shumë, këto janë ato që unë mendoj.

Mirela Kumbaro – Shumë faleminderit, zonja Lleshanaku, për prezantimin dhe detajimin e ideve tuaja!

Ka pyetje ndokush nga kolegët, për të marrë përgjigje plotësuese nga zonja Lleshanaku? Në rregull! Nuk shoh ndonjë dorë të ngritur.

Zonja Lleshanaku, shumë faleminderit për prezantimin dhe për kohën që na dhatë, duke qenë pjesë e diskutimit me ne.

Ju falënderoj dhe ju uroj një ditë të mbarë!

Mirupafshim!

Të dashur kolegë, nëse nuk e kam gabim, na ngelet edhe një kandidate e fundit, që është zonja Mikaela Minga.

Zonja Minga! Po, jeni në linjë. Më dëgjoni? Po. Ju lutem, hapeni mikrofonin.

Mikaela Minga – Përshëndetje!

Mirela Kumbaro - Përshëndetje! Faleminderit që jeni këtu me ne sot!

Mikaela Minga - Faleminderit juve!

Mirela Kumbaro - Fjala është për ju, për të përmbyllur dëgjesat e ditës së sotme. Ndërkohë, si puna e ëmbëlsirës në fund, kjo nuk ju përjashton nga respektimi i rregullit të afatit 10-minutësh, për prezantimin e kandidaturës.

Mikaela Minga - Faleminderit!

Të nderuar anëtarë të nderuar të komisionit. Quhem Mikaela Minga. Mbjaj gradën shkencore Doktor i Shkencave të fituar pranë Universitetit të Milanos në histori dhe kritikë të trashëgimisë artistike dhe ambientale, fituar në vitin 2013.

Aktualisht jam studiuese pranë Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Arteve, Akademia e Studimeve Albanologjike dhe njëkohësisht pedagoge e jashtme pranë Universitetit të Arteve, në lëndët xhaz, *popular music* dhe muzikë filmi.

Përgjithësisht, puna ime është e fokusuar te studimet muzikore, kryesisht të pjesës së Shqipërisë, arealit ballkanik me një frymë krahasuese, domethënë me arealin ballkanik dhe atë mesdhetar.

Kam punuar për muzikat e shekullit XX, siç thashë, dhe fokusi kryesor i viteve të fundit kanë qenë muzikat urbane me dy qytete shqiptare Korçën, me muzikë korçare dhe së fundmi muzikën e Elbasanit, në një monografi që është botuar në vitin 2020, fryt i një projekti kërkimor, thuajse 5 vjeçar- me titull “Tinguj që rrëfejnë, tinguj që rrëfehen”.

Duke marrë parasysh profilin tim edhe përvojën profesionale, mendoj se mund të kontribuoj si anëtare e këshillit drejtues, duke qenë se RTSH-ja për mua përfaqëson një institucion themeltar, i cili bën bashkë traditën historike në fushën e mediave audiovizuale, njëkohësisht pjesën e së tashmes, në të cilën, për mendimin tim, kemi një situatë mjaft komplekse dhe disa herë sfiduese, sa i takon raportit në të shkuarën, raportit me realitetin multimedial dhe sigurisht me teknologjinë dhe çfarë ajo ofron aktualisht sa u takon multimedive. Unë synova të jem koncize, e përmbledhur, për shkak edhe të kohës.

Nuk e di nëse keni ndonjë pyetje apo ndonjë paqartësi në prezantimin tim, mund të më thoni.

Mirela Kumbaro – Në fakt, fusha juaj, siç e prezantuat dhe veten dhe siç e kemi parë, sepse dosjet tuaja personale kanë ardhur dhe kolegët i kanë parë, është shumë qartë e fokusuar te muzikologjia. Nuk e di nëse kolegët kanë ndonjë pyetje. Unë kam një pyetje, meqenëse ju jeni specialiste e mirëfilltë e kësaj fushe. Cili është opinionin tuaj për një ndër institucionet më të rëndësishme të Radio Televizionit Publik Shqiptar, që është orkestra?

Mikaela Minga – Më vjen mirë që ma drejtoni këtë pyetje.

Mendoj që aktualisht kemi problemin sa i takon gjendjes së pandemisë, por mendoj që orkestra simfonike e Radio Televizionit Shqiptar, do të duhet të gëzonte, gati- gati, një status të veçantë brenda këtij institucioni. Mbështes një stinë koncertore më të pasur dhe në të njëjtën kohë

do të doja të punohej disi më shumë. Sa i takon arkivit historik që kjo orkestër përmban, sepse kemi të bëjmë me një situatë në të cilën veprat e kompozitorëve shqiptarë luheshin nga shumë pak formacione, kam parasysh orkestrën simfonike të Teatrit të Operas dhe të RTSH-së, mendoj që duke punuar edhe me arkivin dhe me risjelljen e veprave të kompozitorëve shqiptarë do të sihte një sfidë interesante dhe e mirë.

Mirela Kumbaro – Okej. Mirë.

Unë ju falënderoj për prezantimin dhe për kandidimin!

Ju falënderoj edhe për shkëmbimin që patëm bashkë!

Ju roj një ditë të mbarë!

Mikaela Minga – Gjithashtu!

Mirela Kumbaro – Faleminderit!

Të dashur kolegë, përpara se ta mbyllim, dua t'ju kujtoj, megjithatë do t'i kujtoj sekretarisë së komisionit që ta dërgojë që sot këtë njoftim, që mbledhjen e ardhshme për vendimmarrjen, që zakonisht e bëjmë me dyer të mbyllura, ta bëjmë ditën e premtë. Praktikisht, është krijuar paksa kjo traditë. Po jua them që sot, sepse jemi të gjithë të shpërndarë nëpër zona dhe e dimë që e kemi të zënë axhendën.

Kështu që, ta përcaktojmë që sot për ditën e premtë në orën 9.00.

Imset Beqiraj – Ju lutem!

Mirela Kumbaro – Po, urdhëroni Ismet.

Imset Beqiraj – Ju lutem, unë personalisht nuk vij dot, se kam provim online me studentët dhe jam i angazhuar me këtë gjë.

Mirela Kumbaro – Do ta shikojmë se si do të zhvillohet kjo, në mos të premtën, të enjten, sepse nuk kemi shumë kohë në dispozicion. Në mos gaboj, ngelen edhe dy seanca plenare për vendimmarrje dhe ky është shqetësimi më i madh, për të përdorur sa më mirë kohën që kemi në dispozicion.

Do të merrni njoftim për të kuptuar nëse shumica e kolegëve janë të disponueshëm të enjten në mëngjes në orën 9:00 ose të premtën dhe do ta konfirmojmë maksimumi nesër.

Shumë faleminderit!

Ju uroj ditë të mbarë të gjithëve!

Mirupafshim, kudo që të jeni!

MBYLLET MBLEDHJA